



Nr./Br. 410/25692

Data/Datum 10.11.2022

Gjakovë-Djakovica-Gjakova

DATE/A:	09.10.2022
PËR/ZA/TO:	Zef Qerimi, përfaqësues i konzorciumit Marisa SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K., Rr.Marjan Shabani, Gjakovë
Kopje/Copy/	Arkiva e Komunës Durim Halilaj, Drejtor për Buxhete dhe Financa - Komuna Gjakovës Pjetër Marku, Menaxher i kontratës së AK Organi Mbikqyres "AL-Engineering"
PËRMES/PREKO/THROUGH	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Faton Gutaj, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për shkëputjen e kontratës me numër të prokurimit: - Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa -I-rë, Lot 3: Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Meqë,faza e II-të, me numër identifikues: 632-21-574-5-1-1 dhe nr.të brendshëm: 632-21-003-511.

I/E nderuar,

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 13.12.2021, ne mes te Komunës së Gjakovës dhe Punë kryesit - **Grup i Operatorëve Ekonomik Marisa SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K. për: "Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa -I-rë, Lot 3: Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Meqë,faza e II-të, me numër identifikues: 632-21-574-5-1-1 dhe nr.të brendshëm: 632-21-003-511. dhe nr.protokolli 02-410/04-37319, prej datës 10.11.2022, ndërpritet**, duke u bazuar në nenin 36 dhe 37 paragrafët 37.1 dhe 37.2 nën a, te Pjesa II e Kontratës - Kushtet e Përgjithshme dhe kërkesën e dt.09.11.2022, nga Menaxheri i Kontratës për ndërprerje të kontratës .

Për mos realizimin e Punëve, konformë kushteve të kontratës, jeni të informuar disa here radhazi përmes komunikimeve zyrtare nga Menaxheri i Kontratës si dhe takimeve që keni pasur me Kryetarin e Komunës, Menaxherin e Prokurimit dhe Menaxherin e kontratës .

Përkundër vërejtjeve të shumta Ju nuk ndërmorët veprime të nevojshme për përmirësim e kualitetit dhe dinamikës për realizimin e punimeve. Sipas informatave dhe dëshmive që kemi pranuar nga Menaxheri i Kontratës edhe pse ju është rekomanduar që të vazhdoni punimet, ju nga qershori i vitit fiskal 2022, nuk keni punuar fare me çka është dëshmuar se nuk i keni përmbush obligimet edhe pse kushte kanë qenë te favorshme për realizimin e punimeve.

Si Autoritet Kontraktues që kemi zhvilluar këtë aktivitet të prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën, ju informojmë se menjëherë pas datës 10.11.2022 do ti ndërmarrim të gjitha veprimet konforme kushteve të kontratës - neni 36, paragrafi 36.4 dhe neni 37, paragrafi 37.5 i kontratës.

Shkresës i bashkëngjitet kërkesa e Menaxherit të kontratës për ndërprerje të kontratës.

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	09.11.2022
REFERENC - E:	
PER/ZA/TO:	Zyrën Prokurimit, - z. Faton Gutaj
NGA/OD/FROM:	Menaxheri i Kontratës - Pjeter Marku
CC:	Drejtoria për Shërbime Publike – z. Shkumbin Kastrati Kryetari i Komunës – z. Ardian Gjini Operatori për Mbikëqyrje të Projekteve – AL Engineering shpk
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimi për Ndërprerjen e Kontratës me titull: "Ndërtimi – Asfaltimi i rrugëve ne Meqe, faza e II-të, me nr. identifikues: 632-21-574-5-1-1

Duke u bazuar në pikën 61.27 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe duke u bazuar në ecurinë e punimeve të kësaj kontrate po ju parashtroj këtë rekomandim për ndërprerje të kontratës me titull: 'Ndërtimi – Asfaltimi i rrugëve ne Meqe faza e II-të, me nr. identifikues: 632-21-574-5-1-1 e lidhur me datë 13.12.2021 ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe Grup i operatorëve ekonomik, Marisa SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K.

Arsyetimi:

- Kontrata është nënshkruar ne 13.12.2021, pas përfundimit të procedurave për marrjen e lejes së ndërtimit për projektin në fjalë, pas buxhetimit dhe me fillimin e punimeve iu është dhënë urdhëresë për fillim të punimeve operatorit me datë: 21.03.2022.
- Pas shumë takimeve në mes të Kryetarit të Komunës, Menagjerit të Zyres së Prokurimit dhe Operatorit Ekonomik, Operatori Ekonomik për vitin fiskal 2022, nuk ka punuar nga muaji Qershor.

Duke u bazuar nga ajo që u tha më lart ju rekomandoj që kjo kontratë të ndërpritet duke vepruar në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Me Respekt!



Data:	10/11/2022
Për:	z. Ahmet Tolaj - Divizioni i Pagave
Nga:	z. Gani Rama - Zyrtari Kryesor Financiar
Përmes	z. Ardian Gjini - Zyrtar Kryesor Administrativ
Lënda:	Konfirmim për pagesën e pagave Shëndetësia- Nëntor 2022

I nderuar,

1. **Konfirmoj** se ne kuadër të ndarjeve aktuale buxhetore kemi mjete të mjaftueshme buxhetore për të mbuluar: Për pagat jubilarë si dhe për të siguruar plotësisht pagat për të gjithë stafin edhe për kompletë vitin fiskal sipas ndarjeve buxhetore aktuale për vitin 2022.
2. **Konfirmoj** se me rastin e ekzekutimit të këtyre pagesave me përjashtim nëse ka vendime gjyqësore, në rast se gjatë gjithë vitit do të paraqitet mungesë buxhetore në kategorinë e pagave, e kuptojmë se nuk do të këtë shtim të buxhetit nga Qeveria/Ministria as ne tremujorin e fundit, dhe ne atë rast do të mbeten pa paguar pagat e rregullta për zyrtaret, dhe kjo është plotësisht në përgjegjësinë tone si organizatë buxhetore.
3. **Kërkoj** nga Divizioni i Pagave - Thesari që të ekzekutojë pagesën e listës së kërkesave të dorëzuara sipas dokumenteve të përcjelle nga stafi përgjegjës i Komunës, me rastin e pagesës së pagave mujore, nën përgjegjësinë tonë të plote ligjore (LMFPP, LKBFP, Ligji i buxhetit).

Me respekt!